



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm Sherbimet publike, strehimin dhe rregullimin e territorit

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 01 datë 10 / 04 / 2025

Nr. ____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimeve Nr. 01, 02, 03, 04, nr. Prot ____ datë 04 / 04 / 2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “dhenie ndihme shtetërore financiare per 4 shtetas qe u jane demtuar banesat, si dhe projektit per *Për ripaisjen me autorizim të qytetarit.*

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore),

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015, ”Për vetqeverisjen vendore”, të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, “Për Prefektin e Qarkut Dibër, të ligjit nr.45 datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, të VKM nr.329 datë 16.05.2012, , “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, **kreu III, pika 1, germa ë**, të Udhëzimit nr.263 datë 24.05.2013, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, sipas VKM Nr 216 date 13.04.2023” Per Krijimin e sistemit të integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim (në vijim “sistemi i integruar”), si dhe sipas vendimit të K.Bashkisë Bulqizë me nr.89 datë 26.12.2024, “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Bulqizë për vitin 2025”, **për mbulim dëmi për dëmtim banese nga faktorët natyror apo njerëzorë, si dhe te shkreses nr 492/1 date 25.02.2025**
Ministrise se Mbrojtjes(Agencia Kombetare e Mbrojtjes Civile)mbi perdorimin e fondit te kushtezuar kodi i produktit 91707 AB (Shtetas te ndihmuar banesat e te cileve jane demtuar nga fatkeqesi te ndryshme

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Ne baze të dokumentacionit teknik, situata e qytetareve që u janë demtuar banesat, perfitojne nga fondi i emergjencave civile.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Sektori i Emergjencave Civile

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

Impakti social / grupet që preken:

Qytetaret e Bashkise Bulqize te cilet jane prekur nga deme natyrore.

A është objekt i konsultimit publik:

Jo

Komisioni i Përhershëm për “Sherbimet publike, strehimin dhe rregullimin e territorit”, i mbledhur me datën 10/04/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr __, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “ miratimin fondi per ndihme shteterore financiare“ paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njerën)

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:


T’i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Ernold Supi Kryetar i Komisionit

(emri mbiemri, firma) Shkelqim Beqiri Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Endrit Melg 

Anetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Anetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Data 10/042025